Plagosi me armë 2 persona, kush është personazhi i Tik Tok që u shpall në kërkim

By **lexo.al media** - 15/04/2023 19:45

Një konflikt i nisur në Tik Tok, përfundoi me nxjerrje armësh mes tërinjve në Durrës. Rreth orës 01:15 minuta të mëngjesit 4 të rinj u konflikturan në lagjen numër 10 të qytetit të Durrësit, konflikti agravoi dhe dy të rinj mbetën të plagosur.

Paraprakisht dyshohet se të rinjtë janë plagosur nga një plumb rikoshet që është qëlluar mbi automjetin e tyre nga personi me të cilin kishin shkuar të sqaroheshin pas një sherri në Tik-Tok.

Policia ka shpallur në kërkim Klajdi Mancakun, 25-vjeç pasi dyshohet se ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të Mario Vrionit me të cilin kishte debatuar online dhe në telefon e më pas kishin lënë takim që "të sqaroheshin".

Policia ka ngritur pika kontrolli në akset rrugore dhe po ushtrohen kontrolle në banesa e ambiente ku dyshohet se mund të fshihet 25-vjeçari.

Gjithashtu janë njoftuar pikat e kalimit kufitar, për të mos lejuar largimin e tij jashtë vendit.

Burime policore bëjnë të ditur se dy të rinjtë e përfshirë në konflikt njihen si problematikë.

Nga të shtënat mbeti i plagosur kushëriri i Marios i identifikuar nga policia si Jurgen Vrioni dhe shoku i tyre Arben Haxhiu.

Pas ndihmës mjekësore Jurgen Vrioni ka dalë nga spitali, ndërsa Arben Haxhiu vijon të jetë në spital, jashtë rrezikut për jetën.

Ngjarja u regjistrua në lagjen 10 të Durrësit, pas mesnate.

Nga hetimet e para rezulton se autori i dyshuar, rreth orës 22.30, të mbrëmjes së djeshme ka debatuar në telefon me Mario Vrionin dhe i ka lënë takim për t'u sqaruar në afërsi të shtëpisë së Vrionit.

Duke ndjerë rrezikun, Mario ka marrë kushëririn e tij, Jurgenin dhe shokun e tyre të përbashkët Arben Haxhiun për t'u ballafaqur me Mansakun.

Kur ka shkuar në vendin ku e kishin lënë takimin, sipas deklaratës së tyre, Mansaku, që njihet dhe si shok i reperit Klevio, sapo i ka parë që janë afruar, ka qëlluar me armë zjarri në drejtim të makinës së Mario Vrionit, dhe është larguar menjëherë.

Dyshohet se dy të rinjtë u plagosën lehtë nga një plumb rikoshet.

Pas
"Pashka, mesazh shprese për njerëzit," pastori shpjegon kuptimin e ditës së veçantë

Para
Mero Baze: Berisha përballë dy braktisjeve

ARTIKUJ TE NGJASHEM | ME SHUME


Kush ikën të martën? Ja 5 të nominuarit e kësaj jave në "Big Brother Vip"

Horoskopi Javor (17 – 23 prill 2023)

Stadiumi i boshatisur teksa fliste Berisha, ironizon Desada Metaj: Pra Rama na ka blerë të themi një gjë që duket qartë

Kontrolle në dy lokale në Ohër, dëbohen 12 shtetase të huaja nga Maqedonia e Veriut


Milani "peshkon" përsëri në Francë: Iamtumirë Ibrahimovic

Pamje të frikshme, ushtarit rus i vjen plumbi i snajperit në kokë, por shpëton

Veliaj: "Ku i gjeti Saliu 100 mijë euro që harxhoi në stadium? Non-gratave u ka humbur edhe vula, edhe emri, kanë turp nga emri...

'Do të të vras', arrestohet Cllevio Serbiano në aeroportin e Rinasit! E kallëzoi Noizy

Çdo gjë që duhet të dini për shenjat e horoskopit

Kush ikën të martën? Ja 5 të nominuarit e kësaj jave në "Big Brother...
16/04/2023 13:25

Horoskopi Javor (17 – 23 prill 2023)
16/04/2023 13:19

Stadiumi i boshatisur teksa fliste Berisha, ironizon Desada Metaj: Pra Rama na ka blerë...
16/04/2023 13:10

Kontrolle në dy lokale në Ohër, dëbohen 12 shtetase të huaja nga Maqedonia e...
16/04/2023 12:55

Milani "peshkon" përsëri në Francë: Iamtumirë Ibrahimovic
16/04/2023 12:49

Pamje të frikshme, ushtarit rus i vjen plumbi i snajperit në kokë, por shpëton
16/04/2023 12:31

Veliaj: "Ku i gjeti Saliu 100 mijë euro që harxhoi në stadium? Non-gratave u...
16/04/2023 12:20

'Do të të vras', arrestohet Cllevio Serbiano në aeroportin e Rinasit! E kallëzoi Noizy
16/04/2023 12:13

Çdo gjë që duhet të dini për shenjat e horoskopit
16/04/2023 11:49

Mos dilni pa çadër sot, priten reshje shiu në të gjithë vendin
16/04/2023 11:47

RRETH NESH

Lexo.al përfaqëson një grup gazetarësh të rinj, që synojnë të sjellin lajmin dhe analizën sa më pranë jush. Me profesionalizëm dhe etikë, në mbrojtje të së vërtetës. Na kontaktoni në: marketinglexo.al@gmail.com

NA NDIQ